



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 35

Datë: 12. 08. 2020. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Arianit Elshani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**
 - **Këshilli për Çështje Ligjore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Prishtinë, Kaçanik, Junik dhe Podujevë.
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Memorandum Bashkëpunimit në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Policisë së Kosovës (PK), Prokurorisë së Shtetit (PSh), Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) dhe Komisionit të Pavarur i Mediave (KPM).
 - Njoftim lidhur me procedurën e rekrutimit të pozitës së zëvendës Kryeshfit Ekzekutiv të SKQZ-së.
 - **Këshilli për Personel:**
 - Njoftim lidhur me procedurën e rekrutimit të pozitës së zëvendës Kryeshfit Ekzekutiv të SKQZ-së.
 - Raporti i progresit në zbatimin e planit të rekrutimit dhe nevojat për ndryshim:

3. Vlerësimi vjetor për Drejtorin e ZRPPC-së.
4. Caktimi i Komisionit përzgjedhës për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së.
5. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Kemi pasur probleme të ndryshme, e kemi shty këtë takim sa herë...! A ka dikush vërejtje në agjendë, a ka me shtuar diçka, nëse jo, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Valdete Daka: Vazhdojmë me rendin e mbledhjes...!

2.Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Prishtinë, Podujevë, Kaçanik dhe Junik:

Arianit Elshani: Në mbledhjen e fundit të Këshillit për Çështje Ligjore, bazuar në kërkesat që kanë ardhur për zëvendësime, mbas shqyrtimit dhe analizimit të gjithë dokumentacionit të pranuar, gjykojmë që kemi proceduar në përputhje me rregullat dhe ligjin. Kërkesat, kanë kaluar nëpër filtrat e duhur dhe, nuk ka ndonjë pengesë për procedimin më tej të këtyre zëvendësimeve. Këshilli, i rekomandon KQZ-së për miratimin e këtyre zëvendësimeve:

Valdete Daka: Atëherë, kush është për që z. Shaban Bajoku të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Bunjamin Hoti ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime kanë miratuar këtë rekomandim.

Valdete Daka: Kush është për që znj. Rabije Sallahu, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Afërdita Shehi ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime kanë miratuar këtë rekomandim.

Valdete Daka: Kush është për që z. Muhamet Selmani të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës-PDK", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Uran Ismaili ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime kanë miratuar këtë rekomandim.

Valdete Daka: Kush është për që z. Blerim Gacaferri të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Junik, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës-PDK", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Kreshnik Maloku ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime kanë miratuar këtë rekomandim.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Memorandum Bashkëpunimit në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Policisë së Kosovës (PK),Prokurorisë së Shtetit (PSh), Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Komisionit të Pavarur i Mediave (KPM).

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar edhe memorandumun për bashkëpunimin e KQZ –së me institucionet e tjera, dhe me shumicë të votave ka rekomanduar që KQZ ta votojë këtë memorandum.

Valdete Daka: Memorandumi, tash ka marrë edhe votat në këshillë. A ka dikush diçka me shtuar ? Këtu, shtohet KPM..!

Sami Kurteshi: Për formën ne kemi diskutuar, unë kam abstenuar për të mos penguar punën. Por, unë kam një varg vërejtjesh në tekstin e memorandumit, në përmbajtjen e tij! Unë, kam dërguar vërejtjet, komentet lidhur me tekstin tek kryeshefi dhe drejtori i zyrës ligjore. Për të mos e penguar punën, kam abstenuar me gjithë vërejtjet...

Alim Rama: Ky version, nuk është ndryshe nga memorandumet e tjera. Kisha rekomanduar që të shihen vërejtjet, s'i për shembull në nenin 8, obligimi i Këshillit Gjyqësorë të Kosovës...! Te certifikimi i kandidatëve, duhet ta vendosim një procedurë të veçantë, të ketë një dokument që dëshmon që për shembull, një kandidatë është i dënuar...

Valdete Daka: Ne në vitin 2017 ne, kemi de certifikuar të gjithë kandidatët që kanë pas aktgjykime të plotëfuqishme në 3 vitet e fundit para se me kandiduar. Por, gjykata supreme me aktvendim na ka detyruar t'i certifikojmë përsëri...Ne, nuk mund ta zbatojmë këtë dispozitë...

Ne, nuk mundemi përkundër dëshirës: janë, apo s'janë të dënuar, ne s'mund t'i ndalojmë...

Cështja është në Gjykatën Kushtetuese, duhet të presim se çfarë vendimi do të merr kjo gjykatë, dhe ne do të veprojmë sipas vendimit të saj...

Nëse nuk kemi diçka tjetër, unë e hedh në votim.

Me 2 vota abstenim, anëtarët e KQZ-së miratuan Memorandumin e Bashkëpunimit në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Policisë së Kosovës (PK),Prokurorisë së Shtetit (PSh), Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Komisionit të Pavarur i Mediave (KPM).

3.Këshilli për Personel:

1.Njoftim lidhur me procedurën e rekrutimit të pozitës së zëvendës Kryeshfit Ekzekutiv të SKQZ-së:

Nenad Rikallo: Këshilli nga diskutimet lidhur me këtë pikë, është bërë mbi një kronologji të kësaj çështje që na e ka sjellë Sekretariati. Ajo që është e veçantë të theksohet, është se ne kemi propozime konkrete: të diskutojmë ajo që ne kemi vendosur, dhe çfarë kanë vendosur institucionet e tjera... Kjo është një çështje e zvarritur tash e një vit, dhe ku z. Buzhala nuk e ka marrë funksionin e tij...Ajo që është me rëndësi, është informata e Gjykatës Themelore, por këshilli mendon se KQZ të vendos apo jo...Kemi bërë shqyrtime, kemi analizuar, por s'kemi marrë ndonjë vendim të qartë, kemi pas propozime...

Valdete Daka: Ne, dëgjuam një njoftim nga këshilli për personel, tani a ka dikush me shtue diçka ?

Sami Kurteshi: Ne, rastin e kemi diskutuar edhe në këshill ligjor dhe në atë personel. Janë nxjerrë dëshmi të hapura, dhe në krejt analizën për këtë rast bazuar në dëshmi dhe ligj, unë kërkoj nga KQZ dy veprime alternative:

KQZ të marrë vendim që personi i caktuar të filloj ushtrimin e pozitës së zgjedhur, deri nëse një institucion i caktuar, gjykata nuk sjellë ndonjë vendim tjetër. Procesi, nuk e pengon marrjen apo ushtrimin e detyrës...

Tjetra, KQZ të marrë një vendim, një akt që t'i lejohej ushtrimi i pozitës. Nuk ka një vendim tjetër të KQZ. Pra, deri në këtë moment vlerë ligjore ka akti i përzgjedhjes së personit, dhe ndonjë procedurë tjetër...

Valdete Daka: Kjo është pezullar nga organi i caktuar kompetent...dhe, përderi sa ka një ankesë...Neni 130, e ndalon një veprim të këtillë...

Në debat rreth kësaj çështje, diskutuan më tej: Sami Kurteshi, Valdete Daka, Čemailj Kurtiši, Arianit Elshani, Eshref Vishi gjithnjë duke u mbështetur mbi analiza të caktuara ligjore, shpjeguese rreth normave, ligjeve, akteve etj.

Në fund, z. Kurteshi propozoi ose të marrë vendim pozitiv për çështjen, ose të nxjerrë një vendim që e refuzon ushtrimin e funksionit.

Ky propozim, nuk u miratua nga anëtarët e KQZ-së. (Nuk dëgjohej...)

(P.s. Incizimi, është pjesë – pjesë dhe shpeshëherë nuk dëgjohej, ndërprehet...)

2. Raporti i progresit në zbatimin e planit të rekrutimit dhe nevojat për ndryshim

Nenad Rikallo: Kemi shqyrtuar edhe çështjet e rekrutimit. Kemi analizuar në detaje gjendjen, ka nevojë që të vazhdohet me procedurat e rekrutimit, ato që janë të caktuara. Për më shumë, besoj kryeshefi mund t'ju informoj...

Yll Buleshkaj: Ne, e kemi aprovuar një plan të rekrutimit që kemi filluar ta implementojmë. Pozita e kryeshefit është në procedurë të rekrutimit. Pra, janë diskutuar çështjet, qoftë edhe ajo e zëvendës kryeshefit, pozitat ose çështjet e kryesuesve komunal etj. Pra, disa pozita janë plotësuar, kurse disa janë në procedim e sipër...

Z. Ylli, në detaje i informoi anëtarët e KQZ-së në detaje, qoftë për konkurset e mbaruara me sukses, qoftë për ato që janë në procedurë e sipër, dhe qoftë për ato që do të jenë në radhë...

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, diskutuan: Sami Kurteshi, Valdete Daka, Yll Buleshkaj, Arianit Elshani,

Në fund, kryetarja Daka kërkoi që të votohet lidhur me Raportin e progresit në zbatimin e planit të rekrutimit dhe nevojat për ndryshim.

Me 9 vota për, dhe 2 kundër anëtarët e KQZ-së miratuan ky raport-propozim.

4.Vlerësimi vjetor për Drejtorin e ZRPPC-së

5.Caktimi i Komisionit përzgjedhës për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së

6.Të ndryshme.